



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT
MINISTRI

9289
Nr. ... Prot.

Tiranë, më 12.11.2015

URDHËR

Nr. 434, datë 12.11.2015

PËR

**RISHPËRNDARJEN E KUOTAVE TË PRANIMIT PROGRAMET E STUDIMIT TË
CIKLIT TË PARË DHE PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIMEVE TË CIKLIT
TË DYTË, ME KOHË TË PLOTË, PËR KANDIDATËT NGA REPUBLIKA E KOSOVËS,
SI DHE KANDIDATËT SHQIPTARË NGA MAQEDONIA, MALI I ZI, PRESHEVA,
BUJANOVC I DHE MEDVEGJA, NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË
LARTË, PËR VITIN AKADEMIK 2015 - 2016**

Në mbështetje të Nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 73 dhe 74 Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet shqiptare të arsimit të lartë”, Vendimit nr. 638, datë 22.7.2015 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë në programet e studimeve të ciklit të parë, në programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, si edhe tarifatat e shkollimit për vitin akademik 2015 – 2016”,

URDHËROJ:

1. Rishpërndarjen e 19 kuotave të paplotësuara të pranimit për programet e studimit të ciklit të parë dhe programet e integruara të studimit, për secilin prej institucioneve publike të arsimit të lartë, të parashikuara për kandidatët nga Republika e Kosovës dhe kandidatët shqiptarë nga Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, sipas tabelës bashkëlidhur këtij Urdhri.
2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Sportit, Agjencia Kombëtare e Provimeve dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR



Tabela nr.1 RISHPËRNDARJA E KUOTAVE TË PRANIMIT PËR KANDIDATËT SHQIPTARË NGA TROJET JASHTË KUFIVE TË VENDIT, NË PROGRAMET E STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË TË STUDIEMEVE, PROGRAMET E STUDIEMEVE JOUNIVERSITARE PROFESIONALE, SI DHE PROGRAMET E INTEGRUARA TË STUDIEMEVE TË CIKLIT TË DYTË, ME KOHË TË PLOTË, PËR VITIN AKADEMIK 2015 - 2016,

EMËRTIMI I UNIVERSITETIT	ID PROG RAMIT	EMËRTIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT	Kuota për kandidatët nga Trojet					Totali
			Kosovë	Mali Zi	Maqedoni	Preshevë	Bujanovc	
Universiteti i Tiranës	004	Gazetari			1			1
Universiteti i Tiranës	006	Biologji				2		2
Universiteti i Tiranës	036	Drejtimi	1					1
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	037	Mjekësi e Përgjithshme			1	1		2
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	040	Infiermieri e Përgjithshme	1			5		6
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	043	Fizioterapi				1		1
Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	045	Imazheri				1		1
Universiteti Politeknik i Tiranës	069	Arkitekturë (Urbanist)					1	1
Universiteti Politeknik i Tiranës	077	Inzhinieri Tekstile dhe Mode	1					1
Universiteti Politeknik i Tiranës	085	Inzhinieri Informatike	1					1
Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkoder	184	Turizëm		1				1
Universiteti i Arteve, Tiranë	266	Pikturë				1		1
		Totali	4	1	2	11	1	19